



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec/ Opština Orahovac/ Municipality Rahovec



**Drejtoria Komunale e Arsimit**  
**Odeljenje za Obrazovanje**  
**Department of Education**

Nr i Protokolit: 04/ 1695  
24.04.2024

**Rahovec**

Duke u bazuar në nenin 95 paragrafi 2, nenin 96, nenin 97 dhe nenin 103 paragrafi 2, të Ligjit numër 08L-197 për Zyrtarët publikë, neni 8 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit të punës Nr. 03L-212, nenin 7 dhe 8 të rregullores (QRK) numër 05/2022, për Procedurat Konkurruese dhe Pranimit për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

## KONKURS PËR PRANIM

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

**Emri i pozitës:** Pozitat teknike dhe mbështetëse në Arsim  
**Institucioni:** Komuna e Rahovecit  
**Njësia:** Drejtoria për Arsim  
**Lloji i pozitës:** Nëpunës Teknik dhe Mbështetës  
**Numri i pozitave:** (4) katër  
**Grada/Koeficienti:** 3.76  
**Data e njoftimit:** 24.04.2024  
**Afati për aplikim:** 25.04.2024-09.05.2024

- 2 Punëtor/e Teknik (Mbështetës/e) në Çerdhen e fëmijeve në Ratkoc. Me kohë të caktuar: 40 orë pune në javë;
- 1 Punëtor/e Teknik (Mbështetës/e) në Çerdhen e fëmijëve në Krushë e Madhe Me kohë të caktuar: 40 orë pune në javë;
- 1 Punëtor/e Teknik (Mbështetës/e) në Çerdhen e fëmijeve në Xërxë. Me kohë të caktuar: 40 orë pune në javë.

- **Detyrat Kryesore:**  
Përshkrimi i përgjithshëm i punës;

Personeli shërbyes-teknik, ka për detyrë të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë që janë të përcaktuara në kontratën e punës, si dhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

- **Kërkesat e përgjithshme për pranimit:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

- **Kërkesat e përgjithshme formale:**

- a. Arsimi i kërkuar: **Shkollimi i mesëm** ( në mungesë të kandidatëve me shkollim të mesëm, mund të vijnë në shprehje kandidatët me shkollim të mesëm të ulët ose me shkollim fillor),
- b. Përvoja e punës e kërkuar: **nëse ka.**

- **Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme:**

- a. Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- b. Shkathtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët.

- **Mënyra e aplikimit:**

Dokumentacioni i aplikimit, dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e aplikimit në DKA. Formulari i aplikimit merret në DKA ose shkarkohet nga: <https://konkursi.rks-gov.net>.

- **Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:**

- a. Rezymeja personale (CV);
- b. Kopjet e dokumentit personal( letërnjoftim ose pasaportë);
- c. Kopjet e diplomave të dhënë nga institucionet arsimore ( personat që kanë diplomuar Jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit);
- d. Kopjet e dëshmisë së punësimit; ( nëse ka )
- e. Kopjet e dëshmisë së trajnimeve; ( nëse ka )
- f. Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë ( lëshuar nga Gjykata themelore, jo me e vjetër se 6 muaj).

- **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:**

- a. Vlerësimi i jetëshkrimit ( deri në 30 pikë);
- b. Intervista me gojë ( deri në 70 pikë).

- **Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:**

Përmes ueb faqes së komunës së Rahovecit <https://kk.rks-gov.net/rahovec>.

- **Sqarime shtesë:**

- a. Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistës.
- b. Informata të sakta dhe te vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente ( jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).
- c. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrtarët Publikë.
- d. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e mangëta nuk pranohen.

Rahovec,  
24.04.2024



Drejtori: Avni Morina

*Avni Morina*